



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2024:328527

Datë: 26.12.2024

Numri i dokumentit: 06656223

P.nr.92/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Fatmir Krasniqi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen penale kundër të pandehurit **V. K.** nga fsh..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 lidhur me par. Nënpar. 1.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, me numër PP/II.nr.2422-1/24 të datës 05.12.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 12.12.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Usein Veliji, të dëmtuarës **M. K.** me zyrtarin për mbrojtjen e viktimave Ali Ahmetaj nga Prizreni, të akuzuarit **V. K.** me mbrojtësin e tij të angazhuar me autorizim privat **Av. A. R.** nga Dragashi mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.12.2024 përpiloi edhe këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

V. K., nga i ati **R.**, e ëma **S.**, e vajzërisë **B.**, i lindur me dt... në Dragash, me plotësime tani me vendbanim në fsh..., Komuna e Dragashit, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, me nr. identiteti..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 17.11.2024 rreth orës 10:0 min, në Fshatin... të Komunës së Dragashit, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri **V. K.** i shkakton lëndime të lehta trupore, të dëmtuarës **M. K.** person i ndjeshëm për shkak të marrëdhënieve familjare që kanë-bashkëshortes së tij, në atë mënyrë që në ditën kritike, pas një mosmarrëveshje paraprake ndërmjet tyre derisa e dëmtuara ishte duke qëndruar në dhomën e ndejës në ku prezent ishin fëmijët e tyre vjehrra, fillimisht të dëmtuarës i drejtohet me fjalët "dua të divorcohem nga ti, mos të shoh në shtëpi, shko te familja e juaj", dhe menjëherë fillon ta sulmoj fizikisht me shuplaka fytyrës, veshëve, në shqelm e godet në pjesën e kokës dhe në pjesën e ijëve të anës së majtë, pastaj merr një thupër druri dhe fillon ta sulmoj në pjesën e shpinës, aty ndërhyjnë vjehrra e saj, fëmijët dhe e ndalojnë të pandehurin, nga këto sulme fizike e dëmtuara pëson lëndime trupore në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit, të përshkruara si në akt ekspertizën mjeko ligjore me nr. ref. Pz-5../24 të datës 27.11.2024 ku është konstatuar se e dëmtuara **M. K.** ka pësuar lëndime të lehta trupore si ndrydhje të indeve të buta të nyjeve të kyçit të dorës së majtë, plagë shqyese në regjionit të majtë të buzës si dhe ndrydhje në regjionin

e shpatullës së djathtë të, të konstatuar nga eksperti mjeko ligjor dr. D. H. me datë 27.11.2024.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 pika 3.1 lidhur me par 1 nën par. 1.1 i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në bazë të dispozitave ligjore dhe atë neni 2,4,7,8,17,21,38,39,40,42, 69,70,71 dhe 72 lidhur me nenin 185 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPP-së, të akuzuarin e gjykon me:

DENIM ME BURG

Në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 17.11.2024 – 12.12.2024, të cilin dënim me burgim do ta mbaj në afatin ligjor prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Gjykata konform dispozitave të nenit 452 par. 4 të KPP-së të akuzuarin e liron nga të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

E dëmtuara M. K. nga i ati R. B. me banim në Prishtinë Rr. “M. B.” nr..., V. - Prishtinë me mbrojtësin e viktimave në Prizren Ali Ahmetaj, udhëzohet në realizimin e kërkesës pasurore - juridike me kontest të rregullt civilo juridik.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë me numër PP/II.nr.2422-1/24 të datës 05.12.2024, kundër të akuzuarit V. K. nga fsh..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.1 lidhur me par. Nënpar. 1.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penalë ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar në prezencën e palëve. Është lexuar aktakuza nga prokurori i shtetit. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar akuzën dhe e pranonë fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe provueshmërinë e provave, e ndienë veten fajtor, i premtinë gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërit vepra tjera penale të kësaj natyre.

Prokurori i Shtetit ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nuk e ka kundërshtuar të njëjtën, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së denimit, gjykatës i ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarëve, ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh rrethanat rënduese të propozuara si në aktakuzën duke theksuar shkallën e lartë të dashjes, kemi të bëjmë me viktimën e ndjeshme, vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare, e dëmtuara ka qen e pa mbrojtur, moshë e viktimës dhe dëmtimi i shëndetit i të dëmtuarës.

E dëmtuara M. K. deklaron: Meqenëse këtu i akuzuari e pranoj fajësinë për vepër penale për të cilën e ngarkon aktakuza, unë si e dëmtuar i bashkëngjitem realizimit të kërkesës pasuroro-juridike dhe atë në kontest të rregullt civilo juridik.

Mbrojtësi i viktimave Ali Ahmetaj deklaroi: - Nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë dhe i bashkëngjitem në tërësi fjalës së dhënë nga prokurori i shtetit dhe po ashtu të dëmtuarës. I propozoj gjykatës që në rastin e masës së dënimit të ketë parasysh rrethanat rënduese konform nenit 70 të KP-së, e dëmtuara paraqet kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. A. R. deklaroi: Meqenëse i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet në kuptim të mbrojtjes dëshiroj të potencoj rrethanat lehtësuese për të mbrojturin tim të cilat i propozojmë gjykatës ti merr parasysh me rastin e caktimit të llojit dhe lartësinë të dënimit. I mbrojturi im ka pranuar fajësinë dhe ka shprehur pendës të thellë qysh në rastin të intervistimit të te njëjtit pranë Prokurorisë dhe ka qen bashkëpunues me të gjitha insitucionet e drejtësisë, i njëjta asnjëherë më parë nuk ka ra në ndesh me Ligjin ka përgatitje të ultë shkollore është i gjendjes shumë të dobët ekonomike – rast social, është kryefamiljar, babai i tre fëmijëve, dhe i njëjti kujdeset edhe për bashkëshorten e tij dhe nënën e tij 70 vjeçare. Dhe për veprimet për të cilat është ngritur aktakuza i njëjti në momentin e këtyre veprimeve ka qen i ngarkuar emocionalisht nga diskutimet dhe mosmarrëveshjet e shumta e më tepër se 8 muaj me bashkëshorten e tij këtu të dëmtuarën dhe ka qen i provokuar rëndë në secilën rrethanë dhe situatë e cila i është ofruar të dëmtuarës për të mbajtur të njëjtit përgjigje për kushtet të dobëta ekonomike për ta krahasuar me familjaret tjerë të cilët kanë standard më të lart, për ta fajësuar për vomentin që i njëjti ia kushton motrave të tija edhe për kundër faktit se familja e tyre jeton pikërisht nga remitencat e motrave të tij.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Sa i përket gjendjes faktike konsiderohet se ajo është vërtetuar plotësisht si në përshkrimin faktik të aktakuzës nën kushtet dhe rrethanat ligjore të pranimit të fajësisë.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. A. R. nga Dragashi, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari në këtë shqyrtim ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar se në gjykim ka pas qëndrim korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, se është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar rrethanat familjare me të

dëmtuarën (viktimë e ndjeshme), vepra është kryer brenda marrëdhënjes familjare, e dëmtuara ka qenë e pa mbrojtur, mosha e viktimës si dhe dëmtimi i shëndetit të të akuzuarës, dhe se gjykata pas vlerësimit të të gjitha rrethanave personale të kryesit dhe peshës së veprës penale që ka kryer i akuzuari, ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, të bëjë rehabilitimin e tij dhe me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi për llogaritjen kohës së kaluar në paraburgim në dënimin me burgim të shqiptuar është marrë, në kuptim të nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr konform nenit 452 par. 4. të KPP-së, ngase me pagesën e tyre të pandehurit do të i rrezikohet gjendja materiale.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:328527, 12.12.2024

G j y q t a r i,

Fatmir Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.